




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

1. Furnizimi me kultivator për fermer

Ftohen fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët kultivojnë (kultura bujqësore) në ambiente të hapura, si dhe në ambiente të mbyllura - serra, të aplikojnë për furnizim me kultivator dhe pajisje përcjellëse.

Kriteret e përgjithshme:

- Përkrahen fermerët të cilët kultivojnë (kultura bujqësore) në ambiente të hapur dhe të mbyllur - serra, kulturat: domate, trangull, spec, spinaq, dredhëz (në serrë), marulla (të gjitha varietetet), presh, majdanoz, qepë, hudhër, karotë, lakër, lulëlakër dhe patate;
- Aplikuesi duhet të ketë pronën (sipërfaqen e mbjellë, serrën) në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Të kenë të mbjellë 0.20-0.50/ha me kultura bujqësore në fushë të hapur ose 0.05-0.50/ha në serra;
- Parcela e mbjellë me kulturat bujqësore të lartcekura në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.20/ha e pandarë, ndërsa në serra 0.05/ha;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën, mekanizëm të njëjtë në 3 vitet e fundit;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë tokë me qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët, të noterizuar, në kohëzgjatje prej tri (3) vitesh;
- Fermerët që shfrytëzojnë parcelën me qira e që kanë kontratë të noterizuar, kanë përparësi në raport me fermerët që nuk kanë kontratë të noterizuar.

Kriteret specifike:

- Njohuritë elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Familja (fermerët) pa asnjë anëtarë të punësuar;
- Madhësia e fermës, do të kenë përparësi aplikuesit të cilët kanë sipërfaqe më të madhe të kultivuar me kultura bujqësore të cekura më lart, në raport me ata me sipërfaqe më të vogël dhe atë në kufijtë prej : 0.05-0.50 ha në ambient të mbyllur - serra dhe 0.20-0.50 ha në ambient të hapur;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (masat agro-teknike, sistemi i ujitjes si edhe burimi i ujit);
- Fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të skemave të subvencioneve dhe granteve nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Përparësi do të kenë kultivuesit (fermerët) të cilët kanë, ofrojnë dëshmi - kontrata në lidhje me shitjen e produkteve të tyre për vitin paraprak (2020), si dhe të dëshmoj me faturë të regjistruar ose qarkullim bankar;
- Në kushte të barabarta përparësi do të kenë fermerët që kultivojnë në ambient të hapur dhe ambient të mbyllur ;
- Aplikuesit që kanë sipërfaqe më të madhe të mbjellur me kultura bujqësore, si në ambient të hapur dhe ambient të mbyllur (serra) do të kenë përparësi. Maksimumi i sipërfaqes së përgjithshme (ambient i hapur dhe mbyllur) është 1Ha;

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Kopja e planit;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme në afat deri në një (1) vit ;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Dëshmi-kontrata për shitjen e produkteve;
- Dëshmi nga institucioni përkatës rreth statusit të punësimit.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar t'i sjellë ato në afatin që do t'i përcaktohet, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

Data e aplikimit, prej 02.08.2021 deri më 16.08.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

2. Përkrahje në blegtori – laktofrizë,

Ftohen fermerët e komunës së Prishtinës, të cilët posedojnë gjedhe qumështore, të aplikojnë për furnizim me laktofrizë.

2.1 Furnizimi me laktofrizë 500L

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë banor rezident i komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve të jetë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Të ketë 10 krerë e më shumë gjedhe qumështore;
- Gjedhet qumështore duhet të jenë të matrikuara;
- Nuk kanë të drejt përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare, të cilët kanë përfituar në 3 (tri) vitet e fundit pajisje për ruajtjen e qumështit - laktofriz nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk kanë të drejt përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë fituar mekanizëm bujqësor mbi vlerën 1000€ gjatë vitit 2021;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët dhe të noterizuar;

- Fermerët që shfrytëzojnë parcelën me qira e që kanë kontratë të noterizuar, kanë përparësi në raport me fermerët që nuk kanë kontratë të noterizuar.

Kriteret specifike:

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve qumështore, kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve qumështore;
- Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuar nga Komuna;
- Të kenë njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Familja (fermerët) pa asnjë anëtar të punësuar;
- Madhësia e fermës (numri i gjedheve qumështore/krerë);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (vendi i rregulluar për vendosjen e laktofrizit) sipas standardeve;
- Fermerët të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale për shitjen e qumështit me qumështoret në tri (3) vitet e fundit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Kontratë, marrëveshje me pikën grumbulluese të qumështit (qumështoren);
- Pasqyra financiare për pagesën e qumështit nga ana e qumështores në 3 muajt e fundit;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar t'i sjellë ato në afatin që do t'i përcaktohet, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

Data e aplikimit, prej 02.08.2021 deri më 16.08.2021.